



K.DH.SH.II.nr.14/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar, Franciska Zhitija Ymeri dhe Faton Bajrami, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Qeveria e Kosovës-Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës (MBZHR, kundër të paditurës “D...” shpk-Prizren, me bazë juridike, Kompensim Demi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm , C.nr.542/18, të datës 15.05.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.03.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Qeveria e Republike se Kosovës-Ministria e Bujqësisë dhe Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural Agjencia Pyjore e Kosovës (MBZHR), **PRISHET** pika II (dy) dhe III (tre) e dispozitivit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren nr. C.nr.542/18 të datës 15.05.2019 me të cilën është refuzuar si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë se paditësit ne emër te rikultivimin e tokës pyjore ose kërkesën e kundërvlerës se saj ne shumën 345,942.69€, dhe pjesën qe secila pale i barte shpenzimet e veta procedurale, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale, dhomave të shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

II. Pika I (një) e aktgjykimi të Gjykatës Themelore në Prizren - C.nr.542/18 të datës 15.05.2019, mbetet e pashqyrtuar.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të gjykatës shkallës së parë, është aprovuar pjesërisht si bazuar kërkesëpadia e paditësit për kompensim demi i cili ka rrjedh nga shfrytëzimi i tokës pyjore për 22 muaj ne vlere prej 18332,26€ me kamat ligjore 8, % duke llogarite ate nga data e parashtrimit padisë 03.07.2015 e deri ne pagesën definitive. Ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë ne emër te rikultivimin e tokës pyjore se kërkesën e kundërvlerës se saj ne shumë 345,942.69€, refuzohet si e pabazuar. Secila pale i barte shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilin e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim te gabuar te dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, e datës 10.07.2019, te prishet aktgjykimi i ankimuar vetëm sa i përket kërkesës rikultivim dhe shpenzimet te procedurës dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe

rivendosje apo të ndryshoj Aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.542/18, të datës 15.05.2019.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar në vështrim të nenit 194 i LPK-së, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditës ka paraqitur padie për kompensim demit ne Gjykatën Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm dt. 03.07.2015 me te cilën ka kërkuar nga gjykata qe te aprovohet padia e paditësit dhe te detyrohet paditura te beje pagesën ne emër ete shfrytëzimi te tokës shumen prej 18.333,26€, ndërsa ne emër te ri kultivimit te tokës pyjore të paguaj shumën prej 345,942.69€.

Gjykata shkalles se pare pas administrimit te provave me aktgjykimin e takuar ka gjetur se sipas vlerësimit te gjykatës ne rastin konkret paditës është aprovuar pjesërisht si bazuar kërkesëpadia e paditësit për kompensim demi i cili ka rrjedh nga shfrytëzimi i tokës pyjore për 22 muaj ne vlere prej 18332,26€ me kamat ligjore 8, % duke llogarite ate nga data e parashtimit padisë 03.07.2015 e deri ne pagesën definitive. Ndërsa piken II te dispozitivit eshte refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë ne emër te rikultivimin e tokës pyjore ose kërkesën e kundërvlerës se saj ne shumë 345,942.69€, për arsye se, duke marr parasysh faktin se detyrimi i te paditurit për pagesën e shumes prej 18332,26€ ka paraqitur kushte për vazhdimin e kontratës, dhe si rrjedhoje e kësaj gjykata nuk te arsyeshëm te detyroj te paditurën ne rikultivim e pyllit apo kundërvlerës se saj. Ndërsa vendimi për shpenzime te procedurës është marr ne përputhje me e nenin 450 të LPK-se.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe pas ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar, dhe shkresave të tjera të lëndës, e duke pasur parasysh edhe pretendimet ankimore, gjen se aktgjykimi i kontestuar është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: “në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktgjykimit të ankimuar, tani për tani, nuk e përkrah Dhoma e Shkallës së Dytë, për shkakun se kjo gjykatë me vlerësimin dhe analizimin e tërësishëm të shkresave të lëndës ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar është marrë me shkeljet thelbësor te dispozitave ligjor edhe vërtetemi jo te plot dhe te gabuar te gjendjes faktike për të cilën gjykata e shkallës së dytë çdo herë kujdeset sipas detyrës zyrtare ne kuptim te nenit 194 të LPK dhe e cila shkelje sipas vlerësimit të kësaj gjykate ka ardhur si shkak i vërtetimit jo te plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike me rastin e vendosjes nga ana e gjykatës se shkallës së parë. Për më tepër, dispozitivi i aktvendimit të ankimuar, është kontradiktor dhe

në kundërshtim me arsyet mbi faktet vendimtare në të cilat është thirrur gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes, sepse i njëjti është marrë edhe me shkelje procedurale pasi që në rastin konkret nuk është vërtetuar plotësisht gjendja faktike.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me pretendimin e paditësit për ri kultivimin e tokës pyjore ose kundërvlerën në emër të planit të ri kultivimit shumë 345,942.69€ e ka refuzuar si të pabazuar duke marrë parasysh faktin se detyrimi i të paditurës për pagesën e shumës prej 18,333,26€ ka paraqitur kusht për vazhdimin e kontratës, dhe si rrjedhojë e kësaj gjykata nuk ka vlerësuar si të arsyeshëm që të detyroj të paditurën në ri kultivimin e pyllit apo kundërvlerën saj. Kolegji i kësaj gjykate nuk mbështet vlerësimet juridike dhe faktike të gjykatëse shkallës së parë për arsye se, në njërin anë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se efekti i vazhdimin të kontratës është lidhur me pagën e borxhit të lartecukur, ndërsa në anën tjetër arsyetimin e aktgjykimit ka konstatuar se "me leximin e kontratës nr. 404/08 dt. 30.05.2008 me rastin e nënshkrimit të kësaj kontratë palët kanë pasur për obligim që të paguaj si në vijim, vëllimimin dhe humbjet për produktivitetin e pritshëm të masës drunore në shumë shumen prej 15,795€. Rivitalizimin e sipërfaqes së shfrytëzuar pas përfundimit të punimeve konform planit të ri kultivimit shumen prej 463.350,00€". Nga kjo rezulton se gjykata shkallës së parë në aktgjykimin e atakuar nuk ka bërë vlerësimin e fakteve në harmoni me dispozitat ligjore përkatësisht nuk ka e ka mbështet vendimin në asnjë bazë ligjore si dhe nuk ka shqyrtuar dhe vlerësuar provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, përkatësisht konstatimet e dhëna në arsyetimin të aktgjykimit nuk i ka bazuar në provat e administruara.

Kolegji i Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së dytë, pas analizimit dhe shqyrtimit me kujdes të shtuar të provave që gjenden në shkresat e lëndës e në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa është e bazuar, për arsye se aktgjykimi i atakuar ka të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktvendimit është i pakuptueshëm, kontradiktor me vetvete si dhe ekzistojnë kundërthënie për faktet vendimtare midis asaj që jepet në arsyet të aktgjykimit dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës, respektivisht në arsyetimin të aktgjykimit nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka refuzuar pjesërisht si të pabazuar padinë e paditësit, pa qartësuar plotësisht gjendjen faktike dhe juridike të çështjes respektivisht pa vërtetuar me prova faktet vendimtare kontestuese sepse nga arsyetimi i aktgjykimi i atakuar nuk është e qartë se si gjykata e shkallës së parë ka ardhur të përfundimi se pjesërisht padia është e pabazuar. Shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë andaj aktgjykimi i atakuar, doemos është dashur të prishet.

Aktgjykimi i goditur është i mangët dhe nuk përmban të gjitha elementet dhe pikat e vlerësimit për secilën pretendim të paditësit, për një vendim të arsyetuar, sepse nuk i janë adresuar argumentet thelbësore, me rastin e vlerësimit, për arsye se gjykata e shkallës së parë nuk ka arsyetuar mjaftueshëm refuzimin e padisë së paditësit lidhur me kërkesëpadinë për ri kultivimin e pyllit apo kundërvlerën saj me ç' rast ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të procedurës kontestimore në bazë të nenit 183 të LPK-se pasi nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjen faktike. Kolegji vlerëson se një vendim i arsyetuar i jep një palë mundësinë për t'u

ankuar kundër tij, si dhe mundësinë e shqyrtimit të vendimit nga gjykata e shkallës së dytë. Vetëm duke dhënë një vendim të arsyetuar mund të këtë shqyrtim publik të administrimit të drejtësisë. Funkzioni tjetër i një vendimi të arsyetuar është t'u dëshmojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe t'u ofrojë mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Kjo gjendje faktike, konsiderohet e pavërtetuar në tërësi, marr parasysh këtu pretendimet e të paditësit të cekura në ankesë. Rrjedhimisht, Gjykata në rrethanat e rastit konkret, duke marrë parasysh që Gjykata e shkallës së parë, ka dështuar të adresojë dhe arsyetojë pretendimet thelbësore të parashtruesit të kërkesës të ngritura para saj, andaj, aktgjykimi i atakuar nuk është në përputhje me standardet e një vendimi të arsyetuar gjyqësor, siç përshihet me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-se dhe praktikës gjyqësore të GJEDNJ-se.

Aktgjykimi i atakuar gjithashtu është marrë edhe me shkelje të dispozitës së nenit 160.4 të LPK-se, e cila thekson se arsyetimi duhet të përmbajë kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me ane të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Andaj, për shkak të mangësive të evidentuara më lartë, e që i referohen shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe mos zbatimit të duhur të së drejtës materiale, Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se nuk janë krijuar kushtet ligjore që të mund të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, por është dashur që i njëjti të priset dhe lënda të rikthehet në rigjykim dhe vendosje.

Në lidhje me pretendimet ankimore të palës së paditësit, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në arsyetim të aktgjykimit është dashur ti jep të gjitha vlerësimet e saj, në lidhje me të gjitha çështjet e ngritura nga palët ndërgjyqëse. Gjykata e shkallës së parë ka pasur për obligim që në arsyetim të aktvendimit të trajtojë të gjitha kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat në drejtim të vërtetimit të plote të gjendjes faktike. Prandaj, kjo gjykatë tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë një konstatim të tillë të paraqitur në aktgjykimin e ankimuar, sepse ka të meta për të cilat nuk mund të ekzaminohet, dhe se është juridikisht i paqartë dhe i paqëndrueshëm. Andaj, Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë duhet t'i ftojë palët dhe të hapë shqyrtimin kryesor, të bëjë administrimin dhe vlerësimin e të gjithave provave materiale veç e veç dhe në mënyrë të tërësishme, ato që gjenden në shkresat e lëndës apo prova të tjera eventuale që do të paraqiteshin nga palët, dhe nëse është nevojshme të angazhojë ekspertin të lemisë përkatëse për të vërtetuar saktë gjendjen faktike, lidhur me provat e prezantuara, dhe më pas në mënyrë të drejtë të zbatojë të drejtën materiale, dhe mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, të sjell një vendim të ligjshëm dhe të drejtë, dhe një dispozitiv të qartë, të kuptueshëm dhe të përmbarueshëm.

Meqenëse në rastin konkret aktgjykimi i ankimuar, është prishur pjesërisht edhe për pjesën e shpenzimeve të procedurës, edhe pika III e tij, për të cilat gjykata e shkallës së parë do të vendosë serish në procedurën e rigjykimit dhe rivendosjes, për arsye se gjykata e shkallës së parë është mjaftuar vetëm me theksimin se vendimi për shpenzime të procedurës është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK pa sqaruar se si ka vlerësuar kërkesën për shpenzime dhe pa dhënë fare arsyetim lidhur me kërkesën për shpenzimet e procedurës.

Gjykata ka vendosur sikurse në pikën II të këtij aktgjykimi, pasi që pika I (një) e aktgjykimit të ankimuar, nuk kanë qenë objekt ankimimi.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 194 dhe 195 parag. 1 pika (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.14/22, me datë 10.03.2023

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari

Ramush Bardiqi, d.v